



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:074770
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05637875

CN.nr.3136/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Nora Bllaca-Dula, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.T, nga Sh....., kundër të paditurës Komuna e Shtërpcës të cilën e përfaqëson V.D, avokat nga Shtërpca, objekti i kontestit shujtë, vlera e kontestit 1,430 € duke vendosur sipas propozimit për përsëritjen e procedurës të ushtruar nga paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj –Dega në Shtërpcë, P.br.44/2021, i datës 24.05.2021, me datë 25.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET i pathemeltë propozimi për përsëritje të procedurës i ushtruar nga e paditura Komuna e Shtërpcës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj–Dega në Shtërpcë, P.br.44/2021, i datës 24.05.2021.

A r s y e t i m

E paditura Komuna e Shtërpcës, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur propozim për përsëritje të procedurës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj –Dega në Shtërpcë, P.br.44/2021, i datës 24.05.2021 dhe propozimin e ka bazuar në dispozitat e nenit 232 pika g) e LPK-së.

Përgjigje në propozim nuk ka paraqitur paditësi.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, bëri shqyrtimin e shkresave të lëndës në pajtim me dispozitat e nenit 239 par. 1 të LPK-së dhe pas vlerësimit të thënieve të paraqitura në propozim, gjeti se:

-Propozimi për përsëritjen e procedurës është i pathemeltë.

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë me aktgjykimin C.nr.109/2021 e datës 27.09.2021, në pikën I të dispozitivit ka vendosur të aprovon pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka detyruar të paditurën që të paguaj shumën përgjithshme prej 1,286 € në emër të shujtave për periudhën kohore prej datës 26.04.2018 e deri me datën 01.04.2021, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data e paraqitjes së padis 24.05.2021 e deri në pagesën përfundimtare, ndërsa në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar si të pathemeltë kërkesëpadinë e paditësit përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit dhe atë për shumën 144 € për shkak të parashkrimit të kërkesës. Në pikën III të dispozitivit ka vendosur për shpenzimet e procedurës në shumë prej 30.00 €.

Kundër këtij aktgjykimi ndërgjyqësit nuk kanë paraqitur ankesë.

Pala e paditur në cilësi të propozuesit, propozimin për përsëritje të procedurës e ka mbështetur në nenit 232 pika g) të LPK-së, ndërsa si fakt të ri i është referuar kolegjiut të Gjykatës së Apelit–Departamenti të Përgjithshëm, Divizioni Civil të datës 18.10.2021 me qëllim të unifikimit të praktikës me shumicë votash, kanë vendosur që kontrata e përgjithshme kolektive ka qenë në fuqi deri me datë 31.12.2017, dhe pas kësaj date nuk ka efekt. Sipas pretendimeve të propozuesit po të ekzistonte një përfundim i tillë në kohën e shqyrtimit të çështjes pranë Gjykatës së shkallës së parë, dhe ta kishte mundësinë pala e paditur ta përdorte këtë, situata do të ishte ndryshe, respektivisht në favor të të paditurës, kështu që meqenëse nuk ka kaluar afati prej 30 ditësh nga mbledhja e kolegjiut të Gjykatës së Apelit në të cilën është vendosur sikurse është theksuar më lartë për validitetin e kontratës së përgjithshme kolektive, i ka propozuar Gjykatës së Apelit që të bie aktvendim me të cilin lejon përsëritjen e procedurës dhe e anulon aktgjykimin e shkallës së parë, të datës 24.05.2021.

Gjykata e Apelit duke i vlerësuar pretendimet e mësipërme, gjen se të njëjtat nuk qëndrojnë dhe nuk janë bazë për lejimin e përsëritjes së procedurës. Neni 232 pika g) e LPK-së përcakton se: *“në qoftë se pala merr dijeni për fakte të reja ose gjen prova të reja, ose e fiton mundësinë që ti përdorë ato, në bazë të të cilave për palën do të mund të merrej vendim përfundimtar më i favorshëm, sikurse faktet dhe provat e tilla do të ishin përdorur në procedurën e mëparshme.”*, pra në rastin konkret pala e paditur në këtë rast propozuesi si fakt të ri e ka paraqitur vendimin e marrë nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit në mbledhjen e kolegjiut, mirëpo për Gjykatën e Apelit kjo assesi nuk nënkupton fakt apo provë të re, kjo për faktin se vendimet që merren me qëllim të unifikimit të praktikës janë vendime të cilat nënkuptojnë se Gjykata, respektivisht gjyqtarët të jenë të unifikuar në vendimet e tyre që do të merren në të ardhmen, por assesi nuk nënkupton se këto vendime kanë efekt retroaktiv, pasi që kjo do të shkaktonte pasiguri juridike, sepse qëndrimet mund të ndryshojnë kohë pas kohe varësisht prej situatave të krijuara, mirëpo jo të konsiderohen si fakt i ri që të lejohej përsëritja e procedurës.

Faktet apo provat e reja që i përcakton ligji, më saktësisht pika g), kanë të bëjnë me faktet apo provat e reja lidhur me atë çështje e cila është objekt i shqyrtimit, më saktësisht ato të cilat kanë të bëjnë me gjendjen faktike të çështjes, ndërsa ndryshimi i praktikave të Gjykatave nuk mund të merret si fakt apo provë e re në asnjë rrethanë.

Duke pasur parasysh të thënat më lart, Gjykata e Apelit pas vlerësimit të të gjitha pretendimeve të paditurit në propozimin për përsëritje të procedurës, erdhi në përfundim se nuk ekzistojnë asnjë nga shkaqet nga neni 232 për përsëritje të procedurës, andaj vendosi që propozimin për përsëritje të procedurës ta refuzoj si të pa themeltë.

Gjykata e Apelit konform nenit 239 paragrafi 1, të Ligjit procedurën kontestimore, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke refuzuar përsëritjen e procedurës.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CN.nr.3136/2022, datë 25.04.2024

Gjyqtarja,
Nora Bllaca-Dula, d.v

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh, prej ditës së dorëzimit të aktvendimit, Kolegjit të Gjykatës së Apelit, e duke u bazuar në nenin 240.4 të Ligjit për procedurën kontestimore.